

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 02.03.2022	Numri i vrojtimit të lejes:	07 Nr.89/350-8710
-------------------------	------------------------------------	--------------------------

-Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Leonart Gashi nga Dubrava, Komuna Suharekë, me 07Nr.350-8710 të datës 09.02.2022, në të cilën kërkon dhënien e lejes për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një tavoline lëvizëse - tezgë për shitjen e luleve me rastin e festave të Marsit, në bazë të Rregullores për Tarifatat, Ngarkesat dhe Gjohat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr.16-12102 të datës 01.12.2015 dhe Rregullores - 01 Nr.16-4719 dt. 30.06.2016 për Vendorsjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private, lëshon këtë:

P Ë L Q I M

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Leonart Gashi	Nr. Personal	
Adresa:	Fshati Dubravë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim - për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një tavoline lëvizëse - tezgë për shitjen e luleve me rastin e festave të Marsit.

Përshkrimi:

- I IPET PËLQIMI – z. Leonart Gashi nga Dubrava, Komuna Suharekë për :

-Shfrytëzimin e pasurisë - hapsirës publike për vendosjen e një tavoline lëvizëse - tezgë për shitjen e luleve me rastin e festave të Marsit, në parcelën kadastrale Nr. 2784-1, pasuri shoqërore, në zonën kadastrale Suharekë, në rrugën “ Brigada-123 “ - vendi i quajtur sheshi “ Fadil Vata “, në Suharekë, Komuna Suharekë.

-Shfrytëzimi i hapësirës publike në një sipërfaqe prej 5.00 m² për ushtrimin e veprimtarisë së cekur më lartë, është me karakter të përkohshëm dhe me datë të caktuar nga : **dt. 01.03.2022 deri më 31.03.2022, duke filluar nga ora 08:00 – 20.00.**

-Me rastin e festave komkëtare, tubimeve dhe për nevoja të tjera nga drejtoria e Urbanizmit - jeni të obliguar që objektet e cekura më lartë ti menjaroni për një kohë të caktuar.

-Investuesi gjegjësisht shfrytëzuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër dhe pas përfundimit ta kthejë në gjendjen e mëparshme .

-Për mos respektim të këtij Pëlqimi, inspekcioni përkatës do të veprojë sipas rregullave të parapara me ligj.

A r s y e t i m

-Pranë Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit të Komunës së Suharekës ka parashtruar kërkesë z. Leonart Gashi nga Dubrava, Komuna Suharekë, në të cilën kërkon dhënien e lejes për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një tavoline lëvizëse - tezgë për shitjen e luleve me rastin e festave të Marsit.

- Ky organ pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkëngjitura si dhe Procesverbalit 07Nr.77/350-8710 të datës 25.02.2022 nga Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave për

shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës më pak se një vit, ka konstatuar se parashtuesit të kërkesës mundë të i jepet leja përkatësisht **PËLQIMI** për zhvillimin e aktivitetit të lartpërmendur.

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të tokës ndërtimore.

Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe shfrytëzim të hapsirës publike konform Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5.- në vlerë prej **15.00 euro**.

Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtit .

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtuesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës:
Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë:
Visar Kuçi

